




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova - Ministry of Internal Affairs

AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE
KOSOVSKA AKADEMIJA ZA JAVNU BEZBEDNOST
KOSOVO ACADEMY FOR PUBLIC SAFETY

STRATEGJIA ZHVILLIMORE 2014 – 2018



PËRMBAJTJA

Përkufizimet dhe akronimet	3
Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm.....	5
Hyrje	6
Historiku.....	7
I. Misioni dhe vizioni	8
II. Vlerat	8
III. Metodologjia	9
IV. Parimet e përgjithshme	9
V. Korniza ligjore	10
VI. Objektivat strategjike	10
VII. Mekanizmi ndërinstitucional	12
VIII. Bashkëpunimi ndërkombëtar	13
IX. Implementimi, monitorimi dhe vlerësimi.....	13
X. Plani i Veprimit	15

PËRKUFIZIMET DHE AKRONIMET

AEPC (AKPE)	Asociacioni i Kolegjeve Policore Evropiane
AKA	Agjencia e Kosovës për Akreditim
AKK	Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
AKSP	Akademia e Kosovës për Siguri Publike
AME	Agjencia e Menaxhimit Emergjent
AQAS (ASCAPS)	Agjencia për Siguri të Cilësisë përmes Akreditimit të Programeve Studimore
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
BKUK	Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës
DEZHP	Departamenti i Edukimit dhe Zhvillimit Policor
DTPP	Departamenti i Trajnimit dhe Përkrahjes Programore
DK	Dogana e Kosovës
DP	Divizioni i Personelit
DSHS	Divizioni për Shërbime Studentore
DTI	Divizioni i Teknologjisë Informativë
ENQA (AESCAL)	Asociacioni Evropian për Sigurim të Cilësisë në Arsimin e Lartë
EULEX (MBESL)	Misioni i Bashkimit Evropian i Sundimit të Ligjit
FRIDOM (RFDIM)	Rishikimi Funkcional dhe Dizajnimi Institucional i Ministrive
FSP	Fakulteti i Sigurisë Publike
ICITAP (TKHKPP)	Trajnimi Ndërkombëtar i Hetimeve Kriminale Përkrahja Programore
IHZH	Instituti për Hulumtim dhe Zhvillim
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
KKK	Korniza Kombëtare e Kualifikimeve
KEK	Korniza Evropiane e Kualifikimeve
MAP	Ministria e Administratës Publike
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MD	Ministria e Drejtësisë
MKBK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MF	Ministria e Financave
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare

Organizata ndërkombëtare	Organizata ndërkombëtare kompetente në fushën e trajnimeve
PK	Policia e Kosovës
SHKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës
SHSK	Shërbimi Sprovues i Kosovës
SHSHPK	Shkolla e Shërbimit Policor të Kosovës
Palët e interesit	Institucionet e Sigurisë Publike, duke mos u kufizuar vetëm në: Policia e Kosovës (PK), Dogana e Kosovës (DK), Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK), Shërbimi Sprovues i Kosovës (SHSK), Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) dhe Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME)
Partnerët ndërkombëtarë	Misioni në Kosovë i OSBE-së dhe ICITAP
Projekti i Binjakëzimit	Projekt i Binjakëzimit “Përmirësimi i arsimit në sektorët e rendit dhe sigurisë publike” me numër kontrate KS 09 IB JH 01 i programit të centralizuar të IPA-së 2009 i Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, që ka filluar të zbatohet në mars 2012 dhe përfundon në mars 2014
PZHKB (UNDP)	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNICEF	Fondi për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara
UP	Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”
Vijuesit	Personat të cilët vijnë trajnime dhe arsim të lartë në Akademi
ZBEK	Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZVCK	Zyra për Vlerësimin e Cilësisë dhe Kualitetit

FJALA E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM

Strategjia Zhvillimore dhe Plani i Veprimit 2014 – 2018 është dokument udhërrëfyes i zhvillimit dhe veprimit të cilin personeli i Akademisë dëshiron ta jetësojë në vitet në vijim. Objektivat Strategjike Zhvillimore si dhe Aktivitetet e Planit të Veprimit janë ndërtuar në progresion për më shumë se njëzet muaj.

Kjo periudhë e gjatë e shkruarjes të kësaj strategjie është kushtëzuar nga zhvillimet në Akademi të cilat mund të përmbliken në:

- Periudha pas aprovimit të Ligjit të Akademisë dhe përfundimit të gjitha akteve normative të cilat dalin nga ky Ligj dhe
- Projekti i Binjakëzimit “Përmirësimi i arsimit në sektorët e rendit dhe sigurisë publike”, përmes të cilit do të themelohet arsimi i lartë në Akademi si program studimor katërvjeçar i nivelit Bachelor në fushën e sigurisë publike.

Misioni i Akademisë është definuar në Ligj, kurse vizioni është ndërtuar gjatë zhvillimit të Projektit të Binjakëzimit. Misioni dhe Vizioni në Strategjinë e Akademisë kanë rezultuar nga nevojat e ngritjes të sigurisë publike të qytetarëve me zbatues të ligjit të trajnuar dhe arsimuar mirë. Trajnimet e të gjitha niveleve të cilat zhvillohen në Akademi si dhe arsimi i lartë, i cili do të fillojë me gjeneratën e parë në tetor të vitit 2014, janë rezultate të bashkëpunimit të ngushtë të institucioneve të Kosovës dhe partnerëve ndërkombëtarë, me qëllim të përputhjes së misionit dhe vizionit të Akademisë me standardet e vendeve demokratike.

Njohja e statutit ligjor të Akademisë nga palët e interesit dhe partnerët ndërkombëtarë, është sfida më e rëndësishme me të cilën do të ballafaqohet Akademia në vitet në vijim. Vitet pas themelimit të Akademisë me ligj, 2012 dhe 2013, janë vitet e bashkëpunimit të shkëlqyeshëm të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, Agjencive të Sigurisë Publike dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Personeli i Akademisë do të jetë i përkushtuar në arritjen e objektivave të kësaj strategjie si dhe është i gatshëm të bëjë ndërrimet e duhura pas fazave të vlerësimeve periodike.

Sinqerisht,

Ismail Smakiqi
Drejtore i Përgjithshëm

HYRJE

Kjo Strategji Zhvillimore për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) është rezultat i punës të madhe, të zyrtarëve dhe ekspertëve të Akademisë, Agjencive të Sigurisë Publike dhe partnerëve ndërkombëtarë: Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe ICITAP. Grupi Punues i përbashkët, përmes kësaj strategjie, dëshiron të hap rrugë drejt një Akademie moderne dhe të zhvilluar për të trajnuar dhe arsimuar zyrtarët e institucioneve të sigurisë publike.

Misioni ynë është i qartë: institucioneve të sigurisë publike të Kosovës ju nevojitet ngritje e vazhdueshme profesionale të kuadrove të përgatitur dhe të aftësuar. Ata do të ofrojnë siguri për të gjithë qytetarët e vendit tonë. Që të arrihet kjo, zyrtarët e këtyre institucioneve duhet të kenë programe, pajisje dhe kushte profesionale arsimit dhe trajnimit. Duke pasur një Akademi të sigurisë publike për t'i trajnuar dhe arsimuar zyrtarët e sigurisë publike, do të ofrohet mënyra efektive e shpenzimeve të menaxhimit të burimeve të Akademisë. Për më tepër, Akademia do të mund të gjenerojë edhe të hyra vetanake financiare nga trajnimet dhe shërbimet që ofrohen me pagesë për personat privatë fizikë dhe juridikë. Po ashtu, Akademia ka për qëllim të jetë institucion i arsimit të lartë, duke ofruar shkallën Bachelor, Master dhe, në të ardhmen, shkallën e Doktoraturës (PhD), jo vetëm për studentët e Kosovës, por edhe më gjerë.

Në fund, falënderojmë të gjithë anëtarët dhe ekspertët e Grupit Punues, përkushtimi dhe puna shumë e madhe e të cilëve ka bërë të mundur ta kemi në duart tona këtë Strategji Zhvillimore për pesë vitet e ardhshme. Mbetet që, në të ardhmen, të gjithë palët e interesit të Akademisë të japin kontributin e tyre maksimal për ta implementuar atë, gjë që mund të arrihet vetëm duke forcuar bashkëpunimin që tashmë e kemi. Andaj, me qëllim të realizimit në mënyrë sa më të mirë të kësaj Strategjie Zhvillimore, janë më se të mirëseardhura të gjitha komentet dhe sugjerimet e opinionit dhe palëve të interesit.

HISTORIKU

Kampusi i Akademisë ka ekzistuar që nga mesi i viteve 1960-ta. Në vitin 1971 shëndrrohet në Akademi Policore (shkollë e mesme policore).

Duke filluar nga shtatori i vitit 1999, Departamenti i Edukimit dhe Zhvillimit Policor (DEZHP) i Misionit të OSBE-së në Kosovë, bashkë me UNMIK-un, krijuan një shërbim policor për Kosovën të organizuar, të qëndrueshëm, shërbim i cili respekton dhe zbaton të gjitha parimet e një policie demokratike të orientuar nga komuniteti në një shoqëri multietnike. Faza emergjente, nga viti 1999 deri në fund të vitit 2002, u karakterizua nga trajnimi dhe shpërndarja rapide e Shërbimit Policor të Kosovës rishtazi të formuar.

Faza tranzitore, e cila filloi më 2003-2004, u karakterizua me transformimin e saj nga Shkolla e Shërbimit Policor të Kosovës në institucion të sigurisë publike, duke qenë institucion i trajnimit të Policisë, Doganës, Shërbimit Korrektues dhe Departamentit për Menaxhimin e Emergjencave. Në këtë fazë u bë ndërtimi i kapaciteteve të stafit vendor. Më 2005, faza tranzitore hyri në vitin e saj përfundimtar. Gjatë këtij viti, DEZHP propozoi transformimin e Shkollës së Shërbimit Policor të Kosovës menaxhuar nga DEZHP në një qendër publike të trajnimit, e quajtur Qendra e Kosovës për Siguri Publike Edukim dhe Zhvillim (QKSPEZH).

Nga janari 2006, SHSHPK zyrtarisht u emërua Qendra e Kosovës për Siguri Publike Edukim dhe Zhvillim (QKSPEZH) dhe filloi faza e transferit. Në vitin 2007 përfundoi ky transfer. Qendra iu transferua autoriteteve të përkohshme të Kosovës dhe ishte me staf të plotë nga shërbyesit civilë të Kosovës.

Më 26 mars 2008 përmes Udhëzimit Administrativ Nr. 2008/3, Rregulloreve 2008/17 dhe 2008/18 të UNMIK-ut, u themelua Qendra e Kosovës për Siguri Publike Edukim dhe Zhvillim si agjenci ekzekutive e Ministrisë së Punëve të Brendshme, nën ombrellën e së cilës mbahen trajnime të përbashkëta për të gjithë ofruesit e sigurisë publike, duke u fokusuar veçanërisht në trajnimin bazik, të avansuar, të specializuar dhe atë të menaxhimit dhe lidërshiptit.

Më 18 tetor 2010 nga MPB është aprovuar Udhëzimi Administrativ për Organizimin dhe Strukturimin e Brendshëm të QKSPEZH.

Në dhjetor 2011 ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, sipas të cilit Akademia është agjenci ekzekutive e MPB-së, dhe që ofron trajnim dhe arsim të lartë për të gjitha institucionet e sigurisë publike, por pa u kufizuar vetëm në: Policinë e Kosovës (PK), Shërbimin Korrektues të Kosovës (SHKK), Shërbimin Sprovues të Kosovës (SHSK), Doganën e Kosovës (DK), Agjencinë për Menaxhim Emergjent (AME) dhe Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK).

Akademia është në fazën e zbatimit të Projektit të Binjakëzimit “Përmirësimi i arsimit në sektorët e rendit dhe sigurisë publike”, përmes të cilit do të themelohet arsimi i lartë në Akademi në formën e programit studimor katërvjeçar të nivelit Bachelor në fushën e sigurisë publike. Më 30 shtator 2013, Akademia ka aplikuar për akreditim të këtij programi në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA).

I. MISIONI DHE VIZIONI

Misioni

Akademia ofron shërbime të cilësisë së lartë të arsimit, hulumtimit dhe zhvillimit për agjencionet e sigurisë publike në Republikën e Kosovës.

Vizioni

Në vitin 2020, Akademia do të njihet nga palët e interesit të saj kombëtarë dhe ndërkombëtarë si një institucion parësor për të gjitha nivelet e arsimit në sektorët e rendit dhe sigurisë publike. Anëtarët e personelit të saj do të shfaqin nivel të lartë të profesionalizmit dhe do të jenë tërësisht të përkushtuar për vlerat organizative të AKSP-së dhe për parimin e përmirësimit të vazhdueshëm.

II. VLERAT

Strategjia Zhvillimore e AKSP-së bazohet në këto vlera:

- 1) **Ndershmëria** – Nga secili anëtar i Akademisë pritet të veprojë ndershmërisht në aspektin e punës dhe në jetën private. Kjo është më se e nevojshme dhe e domosdoshme për të bërë të mundshme dhe të realizueshme që AKSP të bëhet model i institucioneve publike. AKSP po ashtu në mënyrë të dukshme do të demonstrojë ndershmëri në proceset vendimarrëse të saj.
- 2) **Transparenca** – Të gjitha proceset e AKSP-së: planifikimet, vendimarrjet, vlerësimet, raportimet dhe të arriturat duhet të jenë tërësisht transparente për të gjithë palët e interesit në theks të strukturës, argumenteve dhe përgjegjësisë.
- 3) **Përgjegjësi e demonstruar (Ilogaridhënie)** – AKSP fuqimisht demonstroi se do të mbajë përgjegjësi të plotë për nivelin e kompetencës të të diplomuarëve. Brenda AKSP-së, secili anëtar i saj do të bartë dhe mbajë përgjegjësi për rezultatet të cilat rrjedhin nga veprimet dhe vendimet e tyre.
- 4) **Etika profesionale** – AKSP vë theksin mbi rëndësinë thelbësore në angazhimin e saj të të gjitha nivelet e arsimit, të praktikave më të mira profesionale dhe vlerat organizative. AKSP si institucion do të jetë shembull në këtë aspekt.

AKSP-ja do të përmbushë misionin e saj duke:

- Luajtur rolin udhëheqës në zhvillimin shkencor dhe profesional të institucioneve të sigurisë publike në Kosovë si dhe duke qenë shembull i praktikës më të mirë në fushat e arsimit, hulumtimit dhe zhvillimit;
- U shquar si themel i arsimit dhe profesionalizmit të mëtutjeshëm në fushën e programeve të sigurisë publike;
- Vazhduar në përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe të trajnimit në fushën e sigurisë publike për të gjithë vijuesit, duke vendosur dhe përmirësuar vazhdimisht sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë;
- Ndihmuar në procesin e zbatimit të ligjit dhe të sigurisë qytetare;
- Riorganizuar strukturën e burimeve njerëzore të bazuar në kornizën ligjore në fuqi, me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të tyre;
- Ofruar shërbimet edhe për personat juridikë dhe fizikë privatë;
- Bashkëpunuar me komunitet dhe institucione tjera kombëtare dhe ndërkombëtare.

III. METODOLOGJIA

Strategjia Zhvillimore e Akademisë është bazuar në parimet që burojnë nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, legjislacioni në fuqi, si dhe në instrumentet ndërkombëtare. Strategjia e AKSP-së është bazuar edhe në praktikën më të mira të institucioneve të akredituara në fushën e sigurisë publike, duke aplikuar standardet më të avancuara ndërkombëtare. Procesi i planifikimit strategjik ka përfshirë konsultime gjithëpërfshirëse me palët e interesit, institucionet tjera qeveritare të Kosovës dhe partnerët tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Metodologjia e hartimit të strategjisë ka përfshirë:

- Studime kualitative nëpërmjet të fokus grupeve të caktuara;
- Grumbullim të literaturës dhe materialit të dokumentacionit brenda AKSP-së;
- Studime krahasuese mes gjendjes aktuale, arritjeve dhe objektivave për të ardhmen;
- Rekomandimet nga raportet mbi vlerësimin e AKSP-së të hartuara në periudha të ndryshme kohore, të kryera nga AQAS, FRIDOM dhe Projekti i Binjakëzimit.

IV. PARIMET E PËRGJITHSHME

Objektivat e parapara në Strategjinë Zhvillimore të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike udhëhiqen nga parimet vijuese:

- 4.1. Parimi i ligjshmërisë** - Personeli, vijuesit dhe personat e tjerë duhet të kryejnë të gjitha punët dhe përgjegjësitë të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
- 4.2. Parimi i profesionalizmit** - Personeli, vijuesit dhe personat e tjerë duhet të veprojnë në mënyrë profesionale në ushtrimin e detyrave të tyre.
- 4.3. Parimi i efikasitetit** - Personeli, vijuesit dhe personat e tjerë duhet të organizojnë punën e tyre të përditshme me korrektësi, përpikshmërisë dhe efikasitet.
- 4.4. Parimi i trajtimit të barabartë dhe i mosdiskriminimit** - Personeli, vijuesit dhe personat e tjerë duhet të respektojnë dinjitetin dhe barazinë e të gjithëve, pa asnjë dallim apo diskriminim të çfarëdo lloji.
- 4.5. Parimi i respektimit** - Personeli, vijuesit dhe personat e tjerë duhet të jenë të sjellshëm dhe ndershëm duke respektuar integritetin dhe personalitetin e njëri-tjetrit.
- 4.6. Parimi i shmangies së konfliktit të interesave** - Personeli, vijuesit dhe personat e tjerë duhet të mos lejojnë që interesat e tyre private të bien ndesh me pozitën e tyre publike, të shmangin konfliktet e interesave dhe të mos shfrytëzojnë asnjëherë pozitën për interesat e tyre private.
- 4.7. Parimi i konfidencialitetit** - Personeli, vijuesit dhe personat e tjerë janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e informacionit të marrë gjatë ushtrimit të përgjegjësisë të tyre të punës dhe të mos e përdorin një informacion të tillë për qëllime të tjera.
- 4.8. Parimi i objektivitetit** - Personeli, vijuesit dhe personat e tjerë nuk duhet të niset nga paragjykimi, favorizimi, apo nga ndikime të tjera, që mund të vënë në rrezik objektivitetin e tij.
- 4.9. Parimi i zhvillimit** - Personeli, vijuesit dhe personat e tjerë duhet të jenë të hapur për zhvillimin e qëndrueshëm dhe gatishmërinë për të kontribuar në këtë proces.
- 4.10. Parimi i vazhdueshmërisë** - Për arritjen e synimeve të kësaj Strategjie Zhvillimore dhe Plani të Veprimit, kërkohet angazhim i vazhdueshëm dhe gjithëpërfshirës i të gjithë institucioneve dhe aktorëve relevantë.
- 4.11. Parimi i paanshmërisë** - Personeli, vijuesit dhe personat e tjerë nuk duhet të jenë të njëanshëm, që do të thotë të kenë një predispozitë në favor të një rezultati të caktuar gjatë vlerësimit të një shtate, duke shkaktuar si pasojë një dëm të pajustificueshëm për interesin e përgjithshëm ose për të drejtat e palëve të tjera të interesuara.

V. KORNIZA LIGJORE

Korniza ligjore që ndërlidhet me implementimin e kësaj Strategjie Zhvillimore, ku si legjislacioni parësor mund të përmendet, por nuk kufizohet vetëm në:

- Ligjin për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike;
- Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës;
- Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin Profesional;
- Ligjin për Veprimtarinë Kërkimore – Shkencore;
- Ligjin për Kualifikime Kombëtare dhe
- Ligjin për Bibliotekat.

VI. OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

Akademia e Kosovës për Siguri Publike është institucion përgjegjës për ofrimin e trajnimit dhe arsimit të lartë, zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit, arsimit të lartë si dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike për të gjitha institucionet e sigurisë publike, por pa u kufizuar vetëm në: Policinë e Kosovës (PK), Shërbimin Korrektues të Kosovës (SHKK), Shërbimin Sprovues të Kosovës (SHSK), Doganën e Kosovës (DK), Agjencinë për Menaxhim Emergjent (AME) dhe Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK).

Kjo arrihet përmes këtyre fushave:

- Trajnimi (trajnimi themelor dhe trajnimet e vazhdueshme profesionale);
- Arsimi i lartë;
- Hulumtimi dhe zhvillimi.

AKSP synon të jetë institucion i arsimit të lartë për shkencat e sigurisë publike që do të ofrojë arsim të lartë për zyrtarët e institucioneve të sigurisë publike, por duke mos u kufizuar vetëm në to, jo vetëm në nivelin e studimeve Bachelor (BA), por edhe në nivelin Master (MA) dhe Doktoraturë (PhD). Akademia do të ketë edhe Institutin për Hulumtim dhe Zhvillim.

Objektivat strategjikë të Akademisë janë me sa vijon:

1. Zhvillimi dhe avancimi i bashkëpunimit me palët e interesit,
2. Zhvillimi i programeve arsimore për të gjitha nivelet që ofrohen në AKSP,
3. Personeli i cili në kuptimin e kompetencës dhe kapacitetit i plotëson kërkesat e arsimit në AKSP,
4. Organizimi i brendshëm dhe infrastruktura i plotësojnë nevojat për zbatimin e misionit të AKSP-së,
5. Sistemi i sigurimit të cilësisë me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm,
6. Funksionalizimi i Institutit për Hulumtim dhe Zhvillim në AKSP.

Objektivi Strategjik 1: Zhvillimi dhe avancimi i bashkëpunimit me palët e interesit

Objektivi specifik 1.1: Të harmonizohen pritshmëritë e palëve të interesit dhe partnerëve ndërkombëtarë

Objektivi specifik 1.2: Fuqizimi i bashkëpunimit me organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurisë

Objektivi specifik 1.3: Ngritja e imazhit të AKSP-së përmes marketingut dhe aktiviteteve promovuese ndaj komunitetit në përgjithësi

Objektivi Strategjik 2: Zhvillimi i kurrikulave për të gjitha nivelet e arsimit që ofrohen në AKSP

Objektivi specifik 2.1: Implementimi i Projektit të Binjakëzimit

Objektivi specifik 2.2: Vlerësimi dhe zhvillimi i kurikulës BA në fushën e sigurisë publike sipas nevojave dhe në bashkëpunim me palët e interesit

Objektivi specifik 2.3: Vlerësimi dhe zhvillimi i kurikulës së trajnimeve sipas nevojave dhe në bashkëpunim me palët e interesit

Objektivi Strategjik 3: Personeli i cili në kuptimin e kompetencës dhe kapacitetit do t'i plotësojë kërkesat e arsimit në AKSP

Objektivi specifik 3.1: Miratimi i strategjisë së personelit

Objektivi specifik 3.2: Punësimi (rekrutimi) i numrit optimal të personelit trajnues dhe mësimdhënës

Objektivi specifik 3.3: Personel profesional, kompetent dhe i motivuar

Objektivi specifik 3.4: Personel efektiv dhe nivel i lartë i performancës së punës për të arritur qëllimet e institucionit

Objektivi Strategjik 4: Organizimi i brendshëm dhe infrastruktura do t'i plotësojë nevojat për zbatimin e misionit të AKSP-së

Objektivi specifik 4.1: Funkcionalizimi i strukturës së re organizative të AKSP-së

Objektivi specifik 4.2: Funkcionalizimi i Fakultetit të Sigurisë Publike në AKSP

Objektivi specifik 4.3: Planifikimi i buxhetit bazuar në nevoja dhe gjenerimi i të hyrave

Objektivi specifik 4.4: Përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës mbështetëse

Objektivi specifik 4.5: Ofrimi i shërbimeve për vijues

Objektivi Strategjik 5: Përmirësimi i vazhdueshëm i sistemit të sigurimit të cilësisë

Objektivi specifik 5.1: Të miratohet strategjia e sigurimit të cilësisë

Objektivi specifik 5.2: Akreditimi e ri-akreditimi nga Agjencia e Kosovës për Akreditim dhe validimi e ri-validimi nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve i programeve arsimore të të gjitha niveleve që ofrohen në AKSP

Objektivi Strategjik 6: Funkcionalizimi i Institutit për Hulumtim dhe Zhvillim në AKSP

Objektivi specifik 6.1: Të miratohet strategjia e hulumtimit dhe zhvillimit

Objektivi specifik 6.2: Mbështetja e proceseve dhe metodave mësimore në fushat e trajnimit dhe zhvillimit të personelit për programet e trajnimit dhe arsimit në AKSP

Objektivi specifik 6.3: Sigurimi i burimeve financiare për hulumtim dhe zhvillim

VII. MEKANIZMI NDËRINSTITUCIONAL

Mekanizmi ndërinstitucional nënkupton rolin dhe koordinimin e aktiviteteve të Qeverisë së Kosovës; Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive gjegjëse; Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë si dhe institucioneve tjera përgjegjëse të Republikës së Kosovës, të cilat kanë rol kyç në implementimin e kësaj Strategjie Zhvillimore.

9.1 Zyra e Kryeministrit – ka rol funksional dhe kyç në aprovimin e akteve normative të propozuara nga Akademia dhe të përkrahura nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe ministritë gjegjëse. Zyra e Kryeministrit propozon Ligjin e Buxhetit në Kuvendin e Kosovës.

9.2 Ministria e Punëve të Brendshme- ka rol funksional në arritjen e objektivave të caktuara në këtë Strategji Zhvillimore, duke u bazuar në hartimin e politikave të mirëfillta për të gjitha agjencitë e pavarura në kuadër të saj, si: Akademia e Kosovës për Siguri Publike, Policia e Kosovës, Inspektorati Policor i Kosovës dhe Agjencia e Menaxhimit Emergjent. Këto agjenci mbajnë takim të rregullt me Ministrin e Punëve të Brendshme dhe kabinetin e Ministrit, në të cilat diskutohen, kordinohen dhe merren vendime për zhvillimet në agjenci.

- **Akademia e Kosovës për Siguri Publike** - është institucioni përgjegjës për të zhvilluar planin strategjik afatgjatë për administrimin efektiv dhe efikas të Akademisë. Akademia bashkërendon aktivitetet me institucionet e sigurisë publike me qëllim të arritjes së objektivave strategjike.

- **Institucionet e Sigurisë Publike** (Policia e Kosovës, Shërbimi Korrektues i Kosovës, Shërbimi Sprovues i Kosovës, Dogana e Kosovës, Agjencia për Menaxhim Emergjent dhe Inspektorati Policor i Kosovës) – kanë rol funksional në arritjen e objektivave të caktuara në këtë Strategji Zhvillimore në cilësinë e palëve të interesit.

9.3 Ministria e Drejtësisë – ka rol funksional në arritjen e objektivave të caktuara në këtë Strategji Zhvillimore, përmes hartimit të politikave për Shërbimin Korrektues dhe Shërbimin Sprovues si shërbime në kuadër të kësaj Ministrie.

9.4 Ministria e Financave – ka rol funksional në arritjen e objektivave të caktuara në këtë Strategji Zhvillimore, përmes hartimit të politikave për Doganën e Kosovës si agjenci e zbatimit të ligjit në kuadër të Ministrisë së Financave.

9.5 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - ka rol funksional në arritjen e objektivave të caktuara në këtë Strategji Zhvillimore, duke u bazuar në faktin se kjo Ministri harton politika lidhur me arsimin dhe aftësimin profesional si dhe arsimin e lartë, të cilat politika duhet të zbatohen nga AKSP.

– **Agjencia e Kosovës e Akreditimit** - ka rol funksional në arritjen e objektivave të caktuara në këtë Strategji Zhvillimore, pasi që është përgjegjëse për akreditimin dhe riakreditimin e institucioneve publike dhe private të arsimit të lartë, në kuadër të së cilës përfshihet edhe AKSP, i cili do të jetë institucion i akredituar i arsimit të lartë në fushën e sigurisë publike.

– **Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve** - ka rol funksional në arritjen e objektivave të caktuara në këtë Strategji Zhvillimore, pasi që është përgjegjëse për validimin dhe rivalidimin e institucioneve të arsimit dhe aftësimin profesional, në kuadër të së cilës përfshihet edhe AKSP, i cili do të jetë institucion i validuar i arsimit dhe aftësimin profesional në fushën e sigurisë publike.

9.6 Ministria e Integrimi Evropiane ka rol funksional në arritjen e objektivave të caktuara në këtë Strategji Zhvillimore, pasi që është përgjegjëse për procesin e integritit evropian në Republikën e Kosovës, politikat e të cilit proces duhet të zbatohen edhe nga AKSP-ja në kuadër të MPB-së.

9.7 Partnerët ndërkombëtarë - roli i partnerëve ndërkombëtarë, OSBE dhe ICITAP, është që, në partneritet me AKSP, nëpërmjet këshillave dhe përkrahjes së tyre, të ndihmojnë në përpilimin dhe implementimin e kësaj Strategjie Zhvillimore.

VIII. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Një ndër faktorët e suksesit në zbatimin e misionit dhe vizionit të Akademisë duke u bazuar në këtë dokument do të jetë bashkëpunimi ndërkombëtar. Përbushja e detyrave në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare si dhe aftësia për të mësuar nga praktikat më të mira, do të ndikojë në rritjen e imazhit, sensibilizimin e opinionit vendor dhe ndërkombëtar për AKSP-në si promotore e vlerave dhe e cilësisë në të gjitha nivelet e trajnimit dhe arsimit në sektorët e rendit dhe sigurisë publike.

Procesi i Bolonjës kërkon përbushjen e një sërë kriteresh të caktuara në ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë. Bazuar në këtë, Akademia e Kosovës i paraqiten detyrat si në vijim, të cilat do të kenë prioritet: mobiliteti i studentëve, profesorëve dhe trajnerëve, bashkëpunimi profesional, garantimi i cilësisë, kurset e gjuhës angleze, pjesëmarrja në projektet ndërkombëtare dhe ndërtimi i rrjeteve për bashkëpunim.

IX. IMPLEMENTIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Akademia e Kosovës për Siguri Publike është institucion përgjegjës për implementimin, monitorimin dhe vlerësimin e Strategjisë.

Implementimi i Strategjisë Zhvillimore do të arrihet përmes realizimit të objektivave strategjike, objektivave specifike dhe aktiviteteve të parapara në Planin e Veprimit.

Monitorimi dhe vlerësimi i realizimit të objektivave dhe efektivitetit të aktiviteteve përkatëse janë pjesë integrale e kësaj Strategjie Zhvillimore të Akademisë dhe komponent kryesor i procesit të zbatimit të saj. Monitorimi dhe vlerësimi do të shërbejnë për të ndjekur ecurinë e strategjisë, për të matur në proces shkallën e realizimit të objektivave të saj, si dhe për të vlerësuar nevojat.

Procesi i implementimit të Strategjisë Zhvillimore do të monitorohet, vlerësohet dhe rishikohet çdo vit nga menaxhmenti i Akademisë. Ky proces duhet të përfshijë tregues të qartë të progresit të bazuar në raportet periodike të njëjësive akademike.

9.1 Dimensionet e monitorimit dhe vlerësimit

Dimensionet kryesore të monitorimit dhe vlerësimit të Strategjisë Zhvillimore janë:

- Kapacitetet institucionale;
- Treguesit e monitorimit përgjatë dhe në fund të periudhës pesëvjeçare;
- Burimet e informacionit dhe instrumentet matëse;
- Shpërndarja dhe përdorimi i rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit.

9.2. Treguesit e monitorimit përgjatë dhe në fund të periudhës pesëvjeçare

Treguesit përfundimtarë, por duke mos u kufizuar vetëm në ta, janë si vijon:

1. Numri i akteve ligjore dhe nënligjore përkatëse që kanë hyrë në fuqi pas miratimit të Strategjisë Zhvillimore;
2. Struktura e krijuar (riorganizimi i brendshëm);
3. Numri i marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe të nënshkruara me institucionet e tjera relevante brenda dhe jashtë vendit;
4. Raportet e monitorimit dhe vlerësimit të Strategjisë Zhvillimore;
5. Numri i trajnimeve dhe ushtrimeve të realizuara në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
6. Numri i studentëve të certifikuar dhe diplomuar;
7. Numri i projekteve të realizuara;
8. Gjendja e përmirësuar e infrastrukturës brenda Akademisë;
9. Akreditimi i programeve të reja dhe ri-akreditimi i programeve ekzistuese;
10. Fushatat, publikimet dhe anketat e realizuara për promovimin e Akademisë;
11. Ngritja dhe përmirësimi i gjendjes financiare;
12. Numri i aktiviteteve të realizuara në mbështetje të OJQ-ve dhe institucioneve tjera publike apo private.

9.3. Burimet e informacionit dhe instrumentet matëse

Instrumentet e monitorimit dhe vlerësimit sigurojnë udhëzime për zhvillimin e Strategjisë Zhvillimore, monitorimin e procesit të planifikimit dhe vlerësimin nëse kjo Strategji është e suksesshme. Prandaj, burime të informacionit dhe instrumente matëse janë:

- Grumbullimi i të dhënave të standardizuara dhe sistemi i përpunimit;
- Të dhënat administrative dhe statistikore nga MPB (Akademia e Kosovës për Siguri Publike, Policia e Kosovës, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave dhe Inspektorati Policor i Kosovës), MD (Shërbimi Korrektues i Kosovës dhe Shërbimi Sprovues i Kosovës), MF (Dogana e Kosovës), MASHT (certifikimi dhe akreditimi);
- Mekanizmat referues kombëtarë dhe ndërkombëtarë;
- Vlerësimi i trajnimit dhe studimit nga institucionet e sigurisë publike (në fushën e zbatimit të ligjit);
- Vlerësimi nga partnerët ndërkombëtarë.

9.4. Shpërndarja dhe përdorimi i rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit

- Rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit do të shpërndahen për të bërë të njohur progresin në AKSP, përkatësisht arritjen e objektivave strategjike dhe atyre specifike.
- Pasi të hartohen raportet e progresit bazuar në të dhënat dhe vrojtimit, ato do të shpërndahen nëpërmjet përdoruesve, të cilët janë partnerë në implementimin e kësaj Strategjie Zhvillimore dhe Plani të Veprimit.

X. PLANI I VEPRIMIT

Plani i veprimit hartohet brenda kornizës së përgjithshme strategjike të përcaktuar në Strategjinë Zhvillimore të AKSP-së.

Plani i veprimit për zbatimin e kësaj strategjie përmban:

1. Objektivat strategjikë;
2. Objektivat specifikë;
3. Aktivitetet konkrete për realizimin e objektiveve;
4. Institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për arritjen e secilit objektiv dhe aktivitet;
5. Afatet kohore për realizimin e secilit objektiv;
6. Burimet e nevojshme financiare për zhvillimin e aktiviteteve;
7. Treguesit për realizimin e secilit objektiv dhe aktivitet.

Plani i Veprimit rishikohet çdo vit nga menaxhmenti i AKSP-së.

Objektivi Strategjik 1: Zhvillimi dhe avancimi i bashkëpunimit me palët e interesit

Objektivi specifik 1.1		Të harmonizohen pritshmëritë e palëve të interesit dhe partnerëve ndërkombëtarë			
Aktivitetet	Afati kohor	Institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja (€)	Treguesit	
1	Takime të rregullta me përfaqësuesit e MPB-së, MASHT-it (institucionet relevante brenda saj) dhe Zyrën e Kryeministrit që ka të bëjë me zhvillimet e mëtejme në AKSP për arsimin e lartë	2014 - 2018	AKSP, MPB, ZKM, MASHT		<ul style="list-style-type: none"> - Së paku një (1) takim në vit. Deri në vitin 2018, së paku pesë (5) takime të mbajtura. - Mundësi të reja financimi dhe përdorimi i së paku 95% të tyre.
2	Plani vjetor për trajnime bazuar në nevojat e palëve të interesit me mundësi rishikimi	2014 - 2018	AKSP, MPB, palët e interesit, partnerët ndërkombëtarë	3,000.00 (Buxheti i AKSP-së)	<ul style="list-style-type: none"> - Një herë në vit mbahet takimi që ka të bëjë me nevojat e palëve të interesit. Deri në vitin 2018 janë realizuar pesë (5) takime. - Janë realizuar 90% e të gjitha ngjarjeve të organizuara nga AKSP-ja, palët e interesit, ose nga organizatat e jashtme të sigurisë, dhe të cilat janë bashkërenduar nga AKSP-ja dhe ku kanë marrë pjesë anëtarët e palëve kyçe të interesit.

Objektivi specifik 1.2		Fuqizimi i bashkëpunimit me organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurisë			
Aktivitetet		Afati kohor	Institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja (€)	Treguesit
1	Marrëveshjet me palët e interesit	2014 - 2015	AKSP, MPB, palët e interesit		- Së paku gjashtë (6) memorandume bashkëpunimi janë nënshkruar deri në vitin 2015
2	Anëtarësimi në organizma të ndryshme përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare	2014 - 2018	AKSP, MPB, organizmat kombëtarë dhe ndërkombëtarë		- Janë arritur pesë (5) marrëveshje të bashkëpunimit me organizma kombëtarë dhe ndërkombëtarë të fushave përkatëse; - Janë nënshkruar së paku pesë (5) marrëveshje bashkëpunimi deri në vitin 2018
3	Organizimi dhe pjesëmarrja në aktivitete (seminarë, konferenca, punëtori, takime të asociacioneve ndërkombëtare, etj.) të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e sigurisë publike brenda dhe jashtë vendit	2014 - 2018	AKSP, MPB, palët e interesit, partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë		Janë realizuar 15 aktiviteteve (seminarë, konferenca, punëtori, etj.) të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e sigurisë publike në AKSP ose në Kosovë
4	Mobiliteti i personelit akademik dhe studentëve	2017 - 2018	AKSP (Fakulteti i Sigurisë Publike), palët e interesit, partnerët ndërkombëtarë		- Procedurat e mobilitetit janë të gatshme deri më 2014, - Buxheti është planifikuar, - Janë lansuar programet dhe projektet e mobilitetit deri në fund të vitit 2018

Objektivi specifik 1.3		Ngritja e imazhit të AKSP-së			
Aktivitetet		Afati kohor	Institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja (€)	Treguesit
1	Përgatitja e broshurave dhe buletinit informator	2014 - 2018	AKSP dhe donatorët		Deri në vitin 2018: - 1500 broshura të prodhuara dhe të shpërndara; - 10 numra të buletinit (secila me nga 300 ekzemplarë) të botuara dhe të shpërndara

2	Promovimi i AKSP-së përmes mediave elektronike dhe të shkruara	2014 - 2018	AKSP, palët e interesit, partnerët ndërkombëtarë dhe donatorët		- Informata të botuara dhe të shpërndara në baza ditore në webfaqen e AKSP-së, portalet informative dhe rrjetet sociale; - 50 lajme të edituara në kanalet televizive ¹ , radio kanalet, gazetat dhe revistat vendore për AKSP-në
3	Organizimi dhe përkrahja e aktiviteteve të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare me qëllim të promovimit të AKSP-së	2014 - 2018	AKSP, partnerët ndërkombëtarë dhe donatorët		75 aktivitete të organizuara ose të përkrahura

Objektivi Strategjik 2: Zhvillimi i kurrikulave për të gjitha nivelet e arsimit që ofrohen në AKSP

Objektivi specifik 2.1		Implementimi i Projektit të Binjakëzimit			
Aktivitetet		Afati kohor	Institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja (€)	Treguesit
1	Përmbyllja e Projektit të Binjakëzimit	Mars 2014	AKSP, Projekti i Binjakëzimit, palët e interesit		- Rezultatet e arritura
2	Aktivitetet përcjellëse që rrjedhin nga Projekti i Binjakëzimit	2014 - 2018	AKSP, palët e interesit		- Arritja e rezultateve në vazhdimësi të Projektit të Binjakëzimit

Objektivi specifik 2.2		Vlerësimi dhe zhvillimi i kurikulës BA në fushën e sigurisë publike sipas nevojave dhe në bashkëpunim me palët e interesit			
Aktivitetet		Afati kohor	Institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja (€)	Treguesit
1	Vlerësimi i kurikulës përmes anketave, intervistave, pyetësorëve etj. përmes studentëve, stafit akademik, palëve të interesit, etj.	2015 - 2018	AKSP (Fakulteti i Sigurisë Publike, ZVCK), palët e interesit		- 15 anketa, intervista, pyetësorë etj. për studentë, stafin akademik, palët e interesit, etj.

¹ Ceremonia e diplomimit të studentëve, reklama (njoftime) për aktivitetet e AKSP-së (organizimi për çdo vit i Mini Olimpiadës për personat me aftësi të kufizuara), etj..

2	Diskutimet dhe përgatitja e amandementimeve (ndryshimeve) për kurrikulë	2016 - 2018	AKSP, palët e interesit		- 20 takime të realizuara
---	---	-------------	-------------------------	--	---------------------------

Objektivi specifik 2.3		Vlerësimi dhe zhvillimi i kurrikulës së trajnimeve sipas nevojave dhe në bashkëpunim me palët e interesit			
Aktivitetet		Afati kohor	Institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja (€)	Treguesit
1	Vlerësimi i planit dhe programit përmes anketave/intervistave/py etësorëve përmes vijuesve të trajnimeve, personelit trajnues, palëve të interesit, etj.	2014 - 2018	AKSP (DTPP, ZVCK), palët e interesit		- 100% të anketave/intervistave/py etësorëve të realizuar përmes vijuesve të trajnimeve, personelit trajnues, palëve të interesit, etj.
2	Diskutimet për planin dhe programin e trajnimeve dhe përgatitja e amandementimeve (ndryshimeve) nëse është e nevojshme	2014 - 2018	AKSP, palët e interesit		- 10 takime të realizuara

Objektivi Strategjik 3: Personeli i cili në kuptimin e kompetencës dhe kapacitetit i plotëson kërkesat e arsimit në AKSP

Objektivi specifik 3.1		Miratimi i strategjisë së personelit			
Aktivitetet		Afati kohor	Institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja (€)	Treguesit
1	Hartimi i strategjisë së personelit	2014	AKSP (Divizioni i Personelit)		Strategjia e personelit e hartuar
2	Implementimi i strategjisë së personelit	2018	AKSP (Divizioni i Personelit)		Strategjia e personelit e implementuar

Objektivi specifik 3.2		Punësimi (rekrutimi) i numrit optimal të personelit trajnues dhe mësimdhënës			
Aktivitetet		Afati kohor	Institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja (€)	Treguesit
1	Rekrutimi i personelit të rregullt akademik	2014 - 2015	AKSP, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”	168,000.00 (buxhetuar) 95,310.84 (shitesa)	20 kontrata të nënshkruara

2	Angazhimi i përkohshëm i personelit akademik	2014 - 2015	AKSP, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, palët e interesit	66,949.80 (shtesa-varësisht nga angazhimi)	20 kontrata të nënshkruara
3	Rekrutimi i personelit të përhershëm trajnues	2014 – 2015	AKSP		10 kontrata të nënshkruara
4	Angazhimi i personelit trajnues	2015 – 2017	AKSP, palët e interesit	54,000.00 (shtesa nga buxheti i AKSP – mallra dhe shërbime)	6 marrëveshje të bashkëpunimit të nënshkruara; 30 kontrata të nënshkruara

Objektivi specifik 3.3		Personel profesional, kompetent dhe i motivuar			
Aktivitetet		Afati kohor	Institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja (€)	Treguesit
1	Trajnimi i personelit drejtues, profesional dhe administrativ	2014 - 2018	AKSP, IKAP, organizatat ndërkombëtare ²	50,000.00 (në vit; 10,000.00 x 5 vjet)	- 95% e trajnimeve të mbajtura; - 90% e personelit drejtues dhe profesional të trajnuar
2	Trajnimi i personelit trajnues dhe mësimdhënës	2014 - 2018	AKSP, organizatat ndërkombëtare, institucione të tjera përkatëse, palët e interesit	50,000.00 (në vit; 10,000.00 x 5 vjet)	- 95% e trajnimeve të mbajtura; - 90% e personelit të trajnues dhe mësimdhënës të trajnuar

Objektivi specifik 3.4		Personel efektiv dhe nivel i lartë i performancës së punës për të arritur qëllimet e institucionit			
Aktivitetet		Afati kohor	Institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja (€)	Treguesit
1	Krijimi dhe implementimi i sistemit të vlerësimit të personelit akademik	2014 - 2018	AKSP (FSP, Divizioni i Personelit)		- Procedurat standarde të përcaktuara; - 5 raporte vjetore të vlerësimit të performancës
2	Krijimi dhe implementimi i sistemit të vlerësimit të personelit trajnues	2014 - 2018	AKSP (FSP, Divizioni i Personelit), palët e interesit		- Procedurat standarde të përcaktuara; - 5 raporte vjetore të vlerësimit të performancës

² Organizata ndërkombëtare kompetente në fushën e trajnimeve

Objektivi Strategjik 4: Organizimi i brendshëm dhe infrastruktura do t'i plotësojë nevojat për zbatimin e misionit të AKSP-së

Objektivi specifik 4.1		Funksionalizimi i strukturës së re organizative të AKSP-së			
Aktivitetet		Afati kohor	Institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja (€)	Treguesit
1	Rregullorja për organizimin e brendshëm të AKSP-së dhe sistematizimin e vendeve të punës	2014	Qeveria, AKSP, MPB, MF, MAP		Rregullorja e miratuar
2	Implementimi i Rregullores për organizimin e brendshëm të AKSP-së dhe sistematizimin e vendeve të punës	2014 - 2015	AKSP, MPB, MF, MAP	Kërkesa për buxhet shtesë në paga dhe mëditje (total 171,940.64): - 66,949.80 personel administrativ dhe trajnues - 95,310.84 Personel i rregullt akademik; - 9,680.00 Bordi dhe Sekretariati i AKSP	<ul style="list-style-type: none"> - Zbatimi i strukturës organizative; - Sistematizimi i vendeve të punës sipas rregullores

Objektivi specifik 4.2		Funksionalizimi i Fakultetit të Sigurisë Publike në AKSP			
Aktivitetet		Afati kohor	Institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja (€)	Treguesit
1	Funksionalizimi i Këshillit të Fakultetit të Sigurisë Publike	2014	AKSP (Fakulteti i Sigurisë Publike)		<ul style="list-style-type: none"> - Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit; - Aprovimi i Rregullores së punës të - Këshillit
2	Funksionalizimi i njërive organizative të Fakultetit të Sigurisë Publike	2014 - 2015	AKSP (Fakulteti i Sigurisë Publike)		<ul style="list-style-type: none"> - Funksionalizimi i pesë (5) Departamenteve të Fakultetit të Sigurisë Publike; - Funksionalizimi i Institutit për Hulimtim dhe Zhvillim

Objektivi specifik 4.3		Planifikimi i buxhetit bazuar në nevoja dhe gjenerimi i të hyrave			
Aktivitetet		Afati kohor	Institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja (€)	Treguesit
1	Përgatitja e planit buxhetor	2014 - 2018	AKSP, MPB		Buxheti vjetor i aprovuar
2	Diskutimi për buxhet me MPB	2014 - 2018	AKSP, MPB		Kërkesat e realizuara
3	Përgatitja dhe implementimi i strategjisë për gjenerimin e të hyrave	2017 - 2018	AKSP		Strategjia e miratuar për gjenerimin e të hyrave

Objektivi specifik 4.4		Përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës mbështetëse			
Aktivitetet		Afati kohor	Institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja (€)	Treguesit
1	Rinovimi i ndërtesave	2014 - 2018	AKSP	300,000.00	Ndërtesat e renovuara
2	Ndërtimi i konviktit të ri	2014	AKSP	35,000.00 (vërejtje: 932,107.66 ka qenë totali)	Përfundimi i ndërtimit të konviktit të ri sipas planit dinamik të paraparë
3	Zhvillimi i bibliotekës dhe pasurimi i fondit të librave	2014 – 2016	AKSP, BKUK (Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës), Partneret nderkombtar, donatoret		<ul style="list-style-type: none"> - Janë siguruar pesëqind (500) tituj në fushat relevante të studimeve të programit; - Është siguruar aplikacioni specifik për qasje elektronike për nevojat e bibliotekës; - Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me BKUK
4	Ndërtimi i objektit të Fakultetit të Sigurisë Publike	2015 - 2016	AKSP	1,750,000.00 (vërejtje: shuma e ndërtimit)	Objekti i ndërtuar

Objektivi specifik 4.5		Ofrimi i shërbimeve për vijues			
Aktivitetet		Afati kohor	Institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja (€)	Treguesit
1	Funksionalizimi i Sektorit për Shërbime Studentore	2014 -2018	AKSP (Divizioni për Shërbime Studentore, Fakulteti i Sigurisë Publike, Divizioni i TI)		<ul style="list-style-type: none"> - Të gjitha dosjet e kompletuara për studentë; - Linku i krijuar për shërbime studentore në kuadër të AKSP-së; - Baza e të dhënave e krijuar për studentë

2	Përgatitja e doracakut të sjelljes për vijues	2014 - 2018	AKSP (Divizioni për Shërbime Studentore, Fakulteti i Sigurisë Publike)		- Doracakut i përgatitur dhe i shpërndarë te vijuesit
3	Përgatitja e doracakut për programet trajnuese dhe studimore	2014 - 2018	AKSP (Sektori për Shërbime Studentore, Fakulteti i Sigurisë Publike)		- Doracakut i përgatitur dhe i shpërndarë te vijuesit
4	Zhvillimi i sistemit informativ për vijuesit	2014 - 2018	AKSP (Divizioni për Shërbime Studentore, Fakulteti i Sigurisë Publike)		- Të publikuara oraret e ligjëratave dhe trajnimeve; - Të publikuara rezultatet e provimeve; - Njoftimi mbi aktivitete të tjera që ndërlidhen me AKSP-në dhe Fakultetin e Sigurisë Publike
5	Administrimi i ankesave dhe ofrimi i këshillave për vijues	2014 - 2018	AKSP (Divizioni për Shërbime Studentore, Fakulteti i Sigurisë Publike)		- Intervistat e zhvilluara; - Administrimi 100% i ankesave të evidentuara; - Ofrimi i këshillave mbi çështjet e vijuesve

Objektivi Strategjik 5: Përmirësimi i vazhdueshëm i sistemit të sigurimit të cilësisë

Objektivi specifik 5.1		Të miratohet strategjia e sigurimit të cilësisë			
Aktivitetet	Afati kohor	Institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja (€)	Treguesit	
1	Zbatimi i doracakut të cilësisë	2014 - 2018	AKSP	- 5 raporte vjetore të vetvlerësimit; - 10 raporte periodike (gjashtëmujore)	
2	Hartimi, aprovimi dhe implementimi i strategjisë së sigurimit të cilësisë	2014 - 2018	AKSP (ZVCK)	Strategjia e cilësisë e implementuar	
3	Plotësimi i standardeve të sigurimit të brendshëm të cilësisë	2014 - 2018	AKSP	Të hartuar raportet vjetore të vet-vlerësimit Janë mbledhur 100% e të dhënave (formave) të informatave kthyes nga studentët, mësimmshënësit dhe të punësuarit	
4	Plotësimi i standardeve të jashtme të sigurimit të cilësisë	2014 - 2018	AKSP, MASHT (AKA, AKK)	Janë dhënë vlerësime pozitive nga Këshilli Kombëtar i Cilësisë (bazuar në kërkesat e plotësuara standarde)	

Objektivi specifik 5.2		Akreditimi e ri-akreditimi nga Agjencia e Kosovës për Akreditim dhe validimi e ri-validimi nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve i programeve arsimore të të gjitha niveleve që ofrohen në AKSP			
Aktivitetet		Afati kohor	Institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja (€)	Treguesit
1	Zbatimi i procedurave përcjellëse për akreditimin e plan-programit mësimor (kurrikulës) të nivelit Bachelor	2014	AKSP, MASHT (AKA), Projekti i Binjakëzimit	Donacion nga Zyra e BE-së në Kosovë	Programi studimor Bachelor në Siguri Publike i akredituar
2	Ri-akreditimi i plan-programit mësimor (kurrikulës) të nivelit Bachelor	2015 - 2018	AKSP (Fakulteti i Sigurisë Publike), MASHT (AKA)	20,000.00 (10,000.00 kostoja e akreditimit x 2 = 20,000.00)	- Dokumentet e përgatitura sipas listës kontrolluese të AKA-së; - Aplikimi në AKA për ri-akreditim; - Bashkëpunimi me AKA për procedurat përcjellëse
3	Zhvillimi dhe verifikimi i standardeve profesionale	2014 - 2018	AKSP (ZVCK, DTPP), palët e interesit, MASHT (AKK)		Standardet profesionale të validuara
4	Validimi dhe ri-validimi i të gjitha trajnimeve profesionale për të gjitha Institucionet e Sigurisë Publike	2014 - 2018	AKSP (ZVCK, DTPP), palët e interesit, MASHT (AKK)		Të gjitha trajnimet për të gjitha Institucionet e Sigurisë Publike të validuara dhe të ri-validuara

Objektivi Strategjik 6: Funkcionalizimi i Institutit për Hulumtim dhe Zhvillim në AKSP

Objektivi specifik 6.1 Të miratohet strategjia e hulumtimit dhe zhvillimit

Aktivitetet		Afati kohor	Institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja (€)	Treguesit
1	Hartimi i strategjisë së hulumtimit dhe zhvillimit	2014	AKSP (Institutit për Hulumtim dhe Zhvillim)		Strategjia e miratuar dhe e zbatuar
2	Plani i punës i hulumtimit	2014	AKSP (Institutit për Hulumtim dhe Zhvillim)		Përgatitja dhe zbatimi i i planit të hulumtimit; Rishikimi vjetor i planit të hulumtimit

Objektivi specifik 6.2		Mbështetja e proceseve dhe metodave të mësimdhënies në fushat e trajnimit dhe zhvillimit të personelit për programet e trajnimit dhe arsimit në AKSP			
Aktivitetet		Afati kohor	Institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja (€)	Treguesit
1	Zhvillimi i kulturës së punës akademike dhe shkencore dhe sistemit të zhvillimit të personelit që inkurajon dhe ndihmon pjesëmarrjen në trajnime dhe zhvillime profesionale	2014 - 2018	AKSP (Instituti për Hulumtim dhe Zhvillim, DTPP, ZVCK), palët e interesit		Deri në vitin 2018 është krijuar sistemi i zhvillimit të personelit për hulumtim dhe zhvillim
2	Përkrahja e aktiviteteve të hulumtimeve nga burimet (përgatitja e temave të diplomës, eseve, bazuar në hulumtime, etj.)	2014 - 2018	AKSP, palët e interesit		<ul style="list-style-type: none"> - Në baza vjetore është bërë analiza e nevojave për literaturë; - Të gjeturat e hulumtimit janë zbatuar në materialet dhe artikujt studimorë dhe janë arkivuar
3	Përkrahja në zbatimin e formave të ndryshme të mësimin (studimit) të bazuara në hulumtim	2014 - 2018	AKSP (Instituti për Hulumtim dhe Zhvillim)		<ul style="list-style-type: none"> - Janë organizuar seri të diskutimeve publike, - 95% e studentëve janë përfshirë në punën e hulumtimit dhe zhvillimit në shkallë të gjërë

Objektivi specifik 6.3		Sigurimi i burimeve financiare për hulumtim dhe zhvillim			
Aktivitetet		Afati kohor	Institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse	Kostoja (€)	Treguesit
1	Ofrimi i mundësive të arsimimit të vazhdueshëm për menaxherët e projekteve dhe hartuesit e aplikacioneve të projektit	2015 - 2018	AKSP (Instituti për Hulumtim dhe Zhvillim), palët e interesit		Janë ofruar 95% e mundësive të arsimimit për menaxherët e projekteve dhe autorët e aplikacioneve të projektit
2	Ngritja e bashkëpunimit me partnerët nga sektori privat dhe publik në fushën e hulumtimit	2015 - 2018	AKSP (Instituti për Hulumtim dhe Zhvillim), partnerët		Numri i projekteve të përbashkëta